



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Opština Drenas – Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Nga/Od/From:

Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2025-2027

Për/Za/To:

Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit

Tema/Subjekat/Subject:

Procesverbali nga procesi i dëgjimit të parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2025-2027

Data/Date: 18 qershor 2024			
REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		18/06/2024	
Numër	Shtojca	Vlera	
01-060/04	-288	28	

P R O C E S V E R B A L

i dëgjimit të parë publik për:

KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE (KAB) 2025-2027

Pas themelimit të Grupit Punues për dëgjimet Buxhetore 2025-2027, sipas vendimit të kryetarit nr. 01-400/01-14708, i datës: 22.03.2024, dhe ftesës për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2025-2027, nr. 01-060/01-27510, i datës 07.06.2024, linqet në ueb-faqe të komunës: <https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/degjime-buxhetore/>; Konsultat publike | Konsultimet publike (rks-gov.net) ; si dhe linku në Facebook: [https://www.facebook.com/komunadrenas?_cft__\[0\]=AZW7niY2geGILk8kYLHMRa5Y6Jl1zqZBdXfbkz8zefde8liYH48cl9wZ24CkkUKlljeQJkNY4OH3xzqajdkbu6yEboNtdxzX6jMYEMhweuVoRO9xCua75mBIMatovnK0ZBHWcAbX6Egh07Kh7l7NxiFg71j7FrmBvbR_Vc6T5ZeafiNroZKswJVrtRCbaKRDNAvjg9w1HwEdcU2NZhXk4x9j&_tn_=-|K-R](https://www.facebook.com/komunadrenas?_cft__[0]=AZW7niY2geGILk8kYLHMRa5Y6Jl1zqZBdXfbkz8zefde8liYH48cl9wZ24CkkUKlljeQJkNY4OH3xzqajdkbu6yEboNtdxzX6jMYEMhweuVoRO9xCua75mBIMatovnK0ZBHWcAbX6Egh07Kh7l7NxiFg71j7FrmBvbR_Vc6T5ZeafiNroZKswJVrtRCbaKRDNAvjg9w1HwEdcU2NZhXk4x9j&_tn_=-|K-R) ; u mbajt takimi i parë publik.





REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Januar	07/06/2024		
QK	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01	27510	



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 07.06.2024

F t e s ë

**Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027**

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr 04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovi së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve me publike me qytetarë për përgatitjen e KAB-it (Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit dhe gjithë të interesuarit, se më datën 13.06.2024, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2025-2027 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzojeni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

KAB-i do të jetë në konsultim publik nga 07.06.2024 deri më 18.06.2024, ndërsa, konsultimet publike me qytetarë do të mbahet më 13.06.2024 në sallën e Kuvendit në orën 10:30 dhe në ora 14:00.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 18.06.2024 në orën 16:00, në e-mail-at e zyrtarëve: albulena.saliuku@rks-gov.net; bekim.dobra@rks-gov.net; avdyli.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për KAB-in, mund t'i referoheni qarkoreve në vegëzat:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:
<https://kk.rks-gov.net/glogoc/category/raportet/>

Platformën për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/>



Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimeve:

Dëgjimet publike për KAB 2024	Data e mbajtjes së dëgjimeve	Vendi	Ora
Dëgjimi i parë publik me grupe të nënperfaqësuar (administratorë të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, etj).	13.06.2024	Salla e Kuvendit	10:30
Dëgjimi i dytë publik me grupe të interesit (biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj).	13.06.2024	Salla e Kuvendit	14:00

Ju mirëpresim!

Bekim Dibra
Udhëheqës i Zyrës për Komunikim me Publikun





KOMUNA E DRENASIT



P R O C E S V E R B A L

Vendi i takimit	Data	Ora
Salla e Kuvendit, Komuna e Drenasit	E enjte, 13 qershor 2024	10:30

Takimi lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore [KAB] 2025-2027, i kryesuar nga udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, u mbajt më 13. 06. 2024, në orën 10:30, në Sallën e Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në takim, përveç bartësve përgjegjës, në përbërje nga: Grupi Punues për Dëgjimet Buxhetore 2025-2027 dhe bartësve mbështetës të dëgjimit, në përbërje nga: Kryetari i Komunës, Nënkryetari i Komunës, Zyra për Informim, Drejtor të Drejtorive dhe njësitet tjera të komunës; ishin të pranishëm edhe: Përfaqësues nga Qendra për Promovimin e Drejtave të Grave, OJQ, përfaqësues të fshatrave, lagjeve si dhe lokaliteteve të ndryshme të komunës së Drenasit.

Udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, duke e hapur takimin i përshëndeti pjesëmarrësit në këtë takim, dhe ndër tjerash tha: I nderuari kryetari i Komunës, z. Ramiz Lladrovci, drejtorë të drejtorive komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës, administratorë të fshatrave, përfaqësues të lagjeve, organizatave jo qeveritare, ju qytetarë.



Jemi mbledhur sot në këtë dëgjim buxhetor për të diskutuar Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027 si dhe Draft-Listën e Investimeve Kapitale për vitet 2025-2027. Ky dokument është përgatitur në bazë të Qarkores Buxhetore 2025/01 të lëshuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, e cila paraqet përmbledhjen e kërkesave fillestare të planifikimit e parashikimit për vitin 2025 dhe projeksionit të buxhetit për vitet 2026-2027.



Komuna me kohë ka bërë njoftimin dhe ftesën. Që nga muaji maj i këtij viti, pasi që kemi pranuar Qarkoren Buxhetore, kemi ftuar ekspertët, OJQ-të, Shoqërinë Civile dhe profesionistët për të kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Komuna e Drenasit shquhet për transparencë e llogaridhënie, ndaj me kohë këto dy dokumente, draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027 dhe draft-Listën e Investimeve Kapitale, do të bëjë publike gjatë kësaj jave dhe ju qytetarë, mund të shihni e të jepni propozime në dëgjimet tjera që do të mbahen gjatë muajit Gusht dhe Shtator.

Ndjej për obligim të ju njoftoj me rregullat e takimit, që diskutimet për buxhet të jenë reciproke me qëllim që të bëhet një përmbledhje me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit. Të nderuar të pranishëm, fillimisht i jap fjalën kryetarit të Komunës, z. Ramiz Lladrovci, për të elaboruar draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Të nderuar qytetarë, të nderuar administrator të fshatrave, duke ju uruar mirëseardhje ju falënderojë që keni gjetur kohë të jeni prezent këtu me ne, në këtë takim që është si hyrje në vazhden e dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Sot në këtë takim do të keni mundësi të prezantoni projektet tuaja që janë në prioritet. Takime të tilla na ndihmojnë të përcaktojmë projektet më jetike për ju, që të i realizojmë në vitet e ardhshme.



Vlen të theksohet se në këtë takim nuk do të diskutohet për raportin e punës së kryetarit, pra nuk do të diskutohet për projektet që kanë përfunduar apo janë në proces. Në këtë takim diskutohen vetëm projektet që janë në prioritetet tuaja për tu implementuar në vitet ardhshme.

Natyrisht ky takim nuk do të jetë i fundit sa i përket identifikimit të prioritetëve tuaja, por që është fillimi i këtij procesi informues me ju si qytetarë dhe si përfaqësues të Bashkësive Lokale, lagjeve, familjeve etj.

Faleminderit për mirëkuptim.



Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim: Të nderuar të pranishëm tani fjalë është për ju, por paraprakisht lus që kur ta merrni fjalën, të prezantoheni për arsye të regjistrimeve dhe mbajtjes së procesit të takimit.

Fjalën e mori **Izet Bytyqi, përfaqësues nga fshati Fushticë e Epërme**, përgëzoi kryetarin **Lladrovci** për punën e deritashme edhe përkundër buxhetit të kufizuar dhe kërkesave të mëdha. Poashtu për vitet vijuese kërkoj ndriçim me arsyetimin se rrjeti i energjisë elektrike ka përfunduar dhe kanalizim në ato lagje ku ende nuk ka përfunduar rrjeti i kanalizimit.

Xhafer Doberdolani, administratori i fshatit Korroticë e Epërme: Kërkoj që të pastrohen mbeturinat, të përfundohen kanalizimet, rrugët dhe trotuarët.

Kadri Ajazi, administrator i fshatit Sankoc: Përshëndetje për të gjithë, në fshatin Sankoc, është punuar dhe po punohet, dhe për këtë ju përgëzoi si komunë. Kanë përfunduar shumë rrugë nëpër fshat dhe shtrirje të rrjetit të kanalizimit poashtu. Për vitet 2025-2027 kërkoj trotuare, ndriçimi të bëhet aty ku ka shtylla të betonit dhe ku është frekuentimi më i madh i qytetarëve.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Kadri, prioritet do të jepet atyre vendbanimeve të cilat janë më të dendura dhe më të frekuentuara.

Doruntina Gashi, OJQ Humanus Vita: kërkoj sqarim rreth Qendrës Rinore në Drenas. A do të ndërtohet Qendra e re apo jo??

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Qendra Rinore është e ndërtuar dhe nuk mund të përfshihet në buxhet. Nëse ka ndonjë donator i cili do të ndërtoj një qendër të re, ne e mirëpresim.

Lendita Elshani, Përfaqësuese e OJQ Handikos: Dua të di diçka me shumë rreth projektit” “Ndertimi shtëpisë së komuniteteve”.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Ky projekt ka filluar të implementohet dhe të ndërtohet gjatë këtij viti e i cili do të vazhdojë edhe gjatë viteve vijuese deri në finalizim të projektit.



Nasuf Mulaku, Administrator i fshatërave Komoran I&II: Komorani I dhe II kanë kërkesë për rrethim të varrezave, trotuare si dhe depërtimin e ujërave të zeza tek rruga “Ymer Alushani”. Mirëpo fillimisht është mirë të informohemi rreth për investimet e vitit 2024 në mënyrë që të dijmë çka të kërkojmë për vitet 2025-2027.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Me datë 28.06.2024 do të mbahet takimi i radhës ku do të raportojm rreth punëve dhe projekteve të cilat janë realizuar dhe ato të cilat janë në proces.

Agim Kacurreti, përfaqësues i fshatit Tërstenik I: në fshatin Tërstenik është punuar shumë dhe për këtë ju përgëzoj. Tersteniku I ka nevojë për një rrugicë 550 metra që të lidh lagjet Kacurreti dhe Dvorani. Poashtu te behet rruga e cila lidh lagjen Kacurreti me parkun e Kamenices.

Zekë Kluna, përfaqësues i fshatit Poklek i Vjetër, Poklek i Ri dhe Vasilevë: Përshëndetje të gjithëve, sa u perket fshatrave të cilat unë përfaqësoj, dua të theksoj që në to është punuar mjaft shumë mirëpo ka nevojë edhe për disa punë tjera. Kërkoj vigun pasi që prona është shpronësuar dhe është në nevojë të banorëve të fshatit tonë. Poashtu kërkoj ndriçim nëpër lagje ku janë pa ndriçim , ujësjellës si dhe një pjesë asfalt. Për Poklek të Ri kërkoj edhe një fushë sportive.

Bajram Qallapeku, administrator i fshatit Tërstenik: Ju përshëndes të gjithëve, dhe falënderoj komunën për punën dhe angazhimin që keni bërë dhe po vazhdoni të bëni. Kam edhe dy kërkesa: ujësjellës për Tërstenikun II si dhe trotuar për Tërstenikun I dhe II.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Sa i përket ujësjellësit, kam menduar që tashmë do të ishte i përfunduar mirëpo të gjithë e dini që pagesat janë realizuar ndërsa gypat kanë mungu. Derisa të zgjidhet kjo çështje nga drejtësia nuk mund të premtoj asgjë.

Ujësjellësin e kemi përfunduar ne Korroticë dhe në Zabel.

Liqenin e Verbocit i kemi fillu procedurat në menyrë që të kemi ujë të mjaftueshëm.

Xhevdet Krasniqi, administrator i fshatrave Negroc dhe Vuqak: Ju përshëndes të gjithëve, kam një kërkesë për rrugën kryesore Arllat- Negroc.

Islam Sylja, Administratorë i fshatërave Shtuticë, Verboc: Kam dy kërkesa për juve, ndriçimi të bëhet në dy lagje si dhe trotuari deri në Shtuticë.

Egzona Tërdeci, Asambleiste: Në listë të projekteve kapitale i keni ndarë për ujësjellës 400.000.00€, a e keni llogarit sa banorë do të përfitojnë nga ky projekt, ndriqim publik- ku do të bëhet, ndërtesa të banimit- të specifikohet çka do të bëhet, asfaltimet- a janë rrugë të reja.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Gryka Gashi do të bëhet nga Qeveria ashtu siç keni deklaruar dhe investimi do të zhvendoset tek pishat në Komoran.

Lendita Elshani, Perfaqësuese e HANDIKOS-it: Këndi i lojërave i cili qenka i përfshirë në listen e projekteve kapitale, kur të ndërtohet të kihet parasysh edhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

Ymri Bajraktari, administrator i fshatit Kishnarekë: Propozoj që Gryka e Kishnarekës të bëhet Park Nacional sepse është vend shumë i përshtatshëm. Kërkesat tjera i kam dorëzuar përmes protokollit.

Ramiz Lladrovci, Kryetari i Komunës: Parqet Nacionale caktohen nga niveli qendror dhe jo nga niveli lokal.

Metodat e konsultimit	Data /Kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve	Numri i komenteve, kërkesave, sugjerimeve	Numri i kërkesave të pranuar
Takimi i drejtpërdrejtë me të gjithë qytetarët e komunës së Drenasit të organizuar nga Kryetari i Komunës dhe grupi punues për dëgjimet buxhetore	13.06.2024 10:30-11:30	59	13	13

* Derisa KAB-i ishte në procesin e konsultimit, kërkesat në formën elektronike nuk janë pranuar.





Bekim Dobra, Udhëheqës i Zyrës për Informim: Ju rikujtoj se kërkesat tuaja për projeksione të ndryshme, mund ti adresoni edhe me shkrim deri me datë 18.06.2024.

Nëse dikush tjetër nuk ka për të shtuar diçka, apo ndonjë kërkesë, duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrjen, ky takim përfundoni tani.

Me kaq takimimi mori fund në orën 11:30.

Dokumentet e bashkëngjitura:

Ftesa për pjesëmarrje;

Lista e pjesëmarrësve; si dhe,

Lista e projekteve kapitale 2025-2027.

Procesmbajtësi

Kimete Qorri

Zyrtare e Lartë për Buxhet dhe Financa





Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit



Lista e pjesëmarrësve në debatin publik për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore
(KAB) 2025-2027

Administratorë, këshilla lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të
kufizuar, punëtor shëndetësor etj

Nr. rendor	Emri	Mbiemri	Nr tel	Nënshkrimi
1	Neef	Bytyqi	044-470-085	Neef
2	XHAFER	DORR	044-761-831	Xhafi
3	OSMAN	BULE	044-646516	Osman
4	Bojani	Galip	049-405438	Bojani
5	Vlora Gjuri	Bytyqi	069929900	Vlora
6	Bohtije Spahiu	Spahiu	049-226-031	Bohtije
7	Zyrtar	Sylla	049-928-023	Zyrtar
8	Aurela	Sahiti	049-969-363	Aurela
9	Edone	Tahiraj		Edone
10	Shalor	Stefan	049-957790	Shalor
11	HARIS Tahir		049-929-884	Haris
12	MEHTER MURAKU		043-542552	Mehter
13	Haris Klercki		044-874-198	Haris
14	FITH	GASHI	044/303/902	Fith
15	Kadi Hys		044-613-079	Kadi
16	Imrullah	Hygolun	044-175-597	Imrullah
17	Arben	Haxhi	044-164-119	Arben
18	Dauubica	Gashi	044-100812	Dauubica
19	Sendita	Elshani	044-196-596	Sendita
20	Blend	Karunacki	049-392-858	Blend
21	Ajme	Karunacki	044-108-155	Ajme
22	Xhendet	Xhendet	044-215-772	Xhendet
23	Imri Baris	KISHI	044-201-296	Imri
24	Egona	Terdari	049-450-237	Egona
25	Elmë	Klara	044-296-399	Elmë
26	Fadil	Trenku	044-164-136	Fadil



27	VHEUDOT	SHISHANI	8/044/289214	SHISHANI
28	Keltrina	Geleka		Geleka
29	Arblanda	Murtez		Murtez
30	Lindan	Berisha	041-589-108	Berisha
31	Manigora	Gllareva	043-654-484	Gllareva
32	Shkendi	Leku	044-539-406	Leku
33	ARMUT	BALA	044-321-069	BALA
34	EELINO	KRSHIQA	049/938 1030	KRSHIQA
35	ZYMERET	MISHORI	044-391-744	MISHORI
36	Floriana	Hasi	043-777-246	Hasi
37	ARTON	HASANI	048-561 215	HASANI
38	Armenia	Rome	041-132-047	Rome
39	Enkele	Demir	049-977-997	Demir
40	Arta	Arduku	045-318-777	Arduku
41	Lumije	Kapri	049-778-444	Kapri
42	Agrese	Kastrioti-Berish	049-567-942	Kastrioti-Berish
43	KUSHTIEM	DASERAKI	044/374-929	DASERAKI
44	PETRI	GADHI	044/500/620	GADHI
45	Hexhmedin	Gruda	049/929-711	Gruda
46	AIBULENA	SALIKU	048-663 665	SALIKU
47	Kimele	Qorri	049 977 979	Qorri

48	Bekim	Dobru	049 974 799	Dobru
49	Arten	Shaba	049 164 522	Shaba

50	ENORIT	GLUKOVA	049258-913	GLUKOVA
----	--------	---------	------------	---------

51	Djellze	Berisha	043-678-315	Berisha
----	---------	---------	-------------	---------

52	AYDYL	MZIL	049 221 880	MZIL
----	-------	------	-------------	------

53	Ramir	Hadrovci		Hadrovci
----	-------	----------	--	----------

54	Benderi	Xhepa	048 160 175	Xhepa
----	---------	-------	-------------	-------

55	Arrian	Gadi	048-552 922	Gadi
----	--------	------	-------------	------

56	Magbule	Hajdari	044-645-332	Hajdari
----	---------	---------	-------------	---------

57	Arben	Gllareva	049-977 784	Gllareva
----	-------	----------	-------------	----------

58	Laureta	Thuzi	049-612-882	Thuzi
----	---------	-------	-------------	-------

59	Mimoza	Berisha	044 910 238	Berisha
----	--------	---------	-------------	---------

P.s: Në këtë takim do të ketë edhe fotografi dhe me nënshkrimin e juaj pajtoni që fotografitë e takimit të përdoren për komunikim zyrtar.



LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE 2015-2017

18 - BKK	21 - THV	Financijal	Totale	VH 2015	Vitromer per 2015	Vitromer per 2017	Totale	Figurativna
61118 - Struktura Pothla, Miroslava Crtka, Pothla								
451	15,000.00			15,000.00	20,000.00	50,000.00	85,000.00	0
451	5,000.00			5,000.00	200,000.00	400,000.00	605,000.00	0
451	5,000.00			5,000.00	60,000.00	300,000.00	365,000.00	0
451	150,000.00			150,000.00	1,421,210.00	2,710,000.00	5,021,210.00	0
451	278,113.00			278,113.00	450,000.00	200,000.00	928,113.00	0
451	500,000.00			500,000.00	500,000.00	600,000.00	1,500,000.00	0
451	300,000.00			300,000.00	500,000.00	350,000.00	1,150,000.00	0
451	810,887.00			810,887.00	955,990.00	200,000.00	1,966,877.00	0
451	100,000.00			100,000.00	274,000.00	200,000.00	574,000.00	0
451	80,000.00			80,000.00	143,000.00	400,000.00	623,000.00	0
451	800,000.00			800,000.00	900,000.00	840,285.00	2,540,285.00	0
451	450,000.00			450,000.00	180,000.00	200,000.00	830,000.00	0
451	50,000.00			50,000.00	280,000.00	150,000.00	480,000.00	0
451	130,800.00			130,800.00	100,000.00	100,000.00	330,800.00	0
451	80,000.00			80,000.00	80,000.00	150,000.00	310,000.00	0
451	80,000.00			80,000.00	100,000.00	100,000.00	280,000.00	0
451	80,000.00			80,000.00	212,545.00	250,000.00	542,545.00	0
451	120,000.00			120,000.00	140,000.00	200,000.00	460,000.00	0
451	100,800.00			100,800.00	150,000.00	150,000.00	400,800.00	0
451	50,000.00			50,000.00	140,000.00	200,000.00	390,000.00	0
451	100,000.00			100,000.00	140,000.00	100,000.00	340,000.00	0
451	100,000.00			100,000.00	180,000.00	100,000.00	380,000.00	0
451	120,000.00			120,000.00	218,000.00	200,000.00	538,000.00	0
451	50,945.00			50,945.00	500,000.00	200,000.00	1,200,000.00	0
451	50,000.00			50,000.00	119,000.00	240,000.00	409,000.00	0
451	300,000.00			300,000.00	300,000.00	300,000.00	900,000.00	0
451	50,000.00			50,000.00	119,000.00	170,000.00	339,000.00	0
451	5,000.00			5,000.00	11,031.00	80,000.00	96,031.00	0
451	5,000.00			5,000.00	10,000.00	150,000.00	165,000.00	0
451	150,000.00			150,000.00	150,000.00	350,000.00	650,000.00	0
451	3,873,945.00			3,873,945.00	8,674,637.00	7,270,265.00	19,828,847.00	0
611189 - Struktura Pothla, Miroslava Crtka, Pothla								
451	50,000.00			50,000.00	20,000.00	20,000.00	90,000.00	0
451	10,000.00			10,000.00	3,000.00	3,000.00	16,000.00	0
451	10,000.00			10,000.00	5,000.00	5,000.00	20,000.00	0
451	10,000.00			10,000.00	10,000.00	10,000.00	30,000.00	0
451	25,000.00			25,000.00	15,000.00	15,000.00	55,000.00	0
611190 - Kulturi, Niti, Sporti								
Struktura Kulturi								



